



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 18 prot.

Kamëz, më 21.3.2025

V E N D I M
Nr. 16 .Datë 21/3 2025
MBI

“MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR MBROJTJEN CIVILE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.03.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.15 Datë 13.03.2025 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile; Ligji nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” ; Ligji nr. 103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë” ; VKM nr. 94, datë 22.02.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023 – 2030 dhe planit të veprimit”; VKM nr.168, datë 24.03.2023 “, Për vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror”; VKM nr. 807, datë 28.12.2023, “ Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”: VKM nr. 923, datë 25.11.2020, “Për funksionimin e organizimit e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile” ; Udhëzimi i përbashkët i gjashtë ministrave nr. 248, datë 28.01.2000, “Për hartimin e planit të alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digave dhe dambave”; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentave për mbrojtjen civile si më poshtë:
 - ❖ Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë (raport paraprak).
 - ❖ Strategjia për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (raport paraprak).
 - ❖ Plani i Mbrojtjes Civile.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi sipas detyrave të përcaktuara në këta dokumenta ngarkohen institucionet dhe drejtoritë në territorin e Bashkisë Kamëz.
3. Ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit për menaxhimin dhe përditësimin e herë pas herëshëm të të dhënave sipas ndryshimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI